
5 PARAMETRAT

Në këtë kapitull është përshkruar procedura për ndryshimin e fontit dhe procedura e hyrjes në departamentin e huazimit. Gjithashtu është përshkruar mënyra e redaktimit të destinacioneve të përdoruesit dhe atyre logjike, në të cilat dërgohen raportet (shih edhe kap. 4.5).

Vazhdon përshkrimi i librit personal të adresave, në të cilin ruhen adresat elektronike të personave me të cilët bashkëpunoni. Është përshkruar edhe mënyra e përcaktimit të filtrit të kërkimit për materialet e çregjistruara, i cili përdoret në dritaren për kërkim të fushës **Fusha 996/997**, mënyra se si dërgohet njoftimi tek të gjithë përdoruesit që ndodhen brenda programit, si lexohet njoftimi i fundit, si lexohet njoftimi i përgatitur në IZUM dhe që ka të bëjë me funksionimin e sistemit COBISS, si kontrollohen njoftimet e dërguara nga programi COBISS3, si përgatitet njoftimi që shfaqet në COBISS+, si dërgohen vërejtjet dhe sugjerimet që kanë të bëjnë me funksionimin e programit, si freskohen parametrat, si kontrollohen gabimet në server, si shfaqet evidenca e aktiviteteve dhe evidenca COBISS3, si dërgohen dy evidencat e fundit (më të rejat) COBISS3 në serverin në IZUM, si bëhet testimi i rrjetit, si shikohet se cilët përdorues të sistemit për momentin ndodhen brenda programit COBISS3 dhe si kontrollohet përpunimi i të dhënave personale.

Të gjithë parametrat janë të lidhur me emrin e përdoruesit. Madhësia e dritareve pas mbylljes së shfletuesit ruhet. Parametrat e tjerë të përdoruesit – fonti, destinacionet e përdoruesit, destinacionet logjike, libri personal i adresave, filtri i kërkimit për materialet e çregjistruara, pyetësorët, shkurtoret, formatet e rezultateve të kërkimit si dhe madhësia e pozicioni i dritares me listën dyshe – ruhen menjëherë pas përcaktimit të parametrat të veçantë të përdoruesit.

Nënkapitujt:

- Rregullimi i fontit
- Hyrja në departamentin për huazim
- Përcaktimi i destinacioneve të përdoruesit
- Redaktimi i destinacioneve logjike
- Redaktimi i librit personal të adresave
- Vendosija e filtrit të kërkimit për materialet e çregjistruara
- Dërgimi i njoftimeve për përdoruesit e sistemit
- Leximi i njoftimit të fundit

- Njoftimi i përdoruesve të sistemit
- Pasqyra e njoftimeve
- Përgatitja e njoftimeve për COBISS+
- Dërgimi i vërejtjeve
- Freskimi i parametrave
- Shfaqja e gabimeve në server
- Shfaqja e evidencës së aktiviteteve
- Shfaqja e evidencës COBISS3
- Dërgimi i evidencës COBISS3
- Testimi i rrjetit
- Shfaqja e përdoruesve aktualë të sistemit
- Përpunimi i të dhënave personale në përputhje me Ligjin për mbrojtjen e të dhënave personale